



---

**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**

**PLAN INTEGRITETI  
2023 - 2024**

Ky Plan Integriteti është hartuar në përmbushje të objektivit strategjik A.9 *“Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë”* dhe A.9.4 *“Hartimi/miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet e varësive të ministrive”* të Planit të Veprimit 2020-2023 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miratuar me VKM Nr.247, datë 20.03.2015, të ndryshuar.

Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit për evidentimin e hapësirave për korrupsion dhe forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, nëpërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL .....</b>	<b>4</b>
<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>6</b>
<b>MIRATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT.....</b>	<b>9</b>
<b>PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....</b>	<b>10</b>
<b>QASJA METODOLOGJIKE.....</b>	<b>10</b>
<b>OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2023-2024.....</b>	<b>11</b>
<b>RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT.....</b>	<b>12</b>
<b>MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT.....</b>	<b>35</b>
<b>PLANI I VEPRIMIT.....</b>	<b>36</b>
<b>Objektivi 1 - Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse</b>	
<b>Objektivi 2 - Transparenca me publikun</b>	
<b>Objektivi 3 - Menaxhimi i buxhetit dhe financës</b>	
<b>Objektivi 4 - Menaxhimi i sektorit të kimikateve</b>	
<b>Objektivi 5 - Menaxhimi i sektorit të ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)</b>	

## **DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL**

Përballja efektive me korrupsionin për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit është tepër e rëndësishme në zbatim të funksioneve që ka kjo Agjenci referuar VKM-së nr.568., datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion. Plani përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe masat konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi i tij është përmirësimi i praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e kredibilitetin institucional.

## **LISTA E SHKURTESAVE**

**MTM - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**

**SNKK - Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit**

**GMS - Grupi i Menaxhimit Strategjik**

**AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit**

**ARM - Agjencia Rajonale e Mjedisit**

**SBNJ - Sektori i Burimeve Njerëzore**

**VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave**

**NZ - Nëpunësi Zbatues**

**NA - Nëpunësi Autorizues**

**KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit**

**MVRI - Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit**

## **HYRJE**

Plani i Integritetit për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit u hartua në periudhën Maj - Korrik 2023.

### **Kuadri i përgjithshëm ligjor mbi bazën e të cilit funksionon Agjencia Kombëtare e Mjedisit përfshin, por pa u kufizuar vetëm në:**

- Ligj Nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore;
- Ligj Nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore
- Ligj Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar;
- Ligj Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” dhe akteve të tjera nënligjore;
- Ligj Nr. 10 463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore;
- Ligj Nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”;
- Ligj Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj Nr. 10440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM Nr. 402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”;
- VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” e ndryshuar;
- VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”;
- VKM Nr. 417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit” e ndryshuar;
- VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentet e transferimit”;
- VKM Nr. 247, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;
- VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 “Për mbetjet spitalore”;
- VKM Nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- Ligj Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Kodi i Procedurës Civile;
- Ligj Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- Kodi i Punës;
- Ligj Nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike”;
- Ligj Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

- Ligj Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Ligj Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligj Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligj Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- Ligj Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shteteror”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligj Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe akte të tjera nënligjore për rregullat e prokurimit publik;
- Udhëzimi Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

#### **Kuadri i brendshëm rregullator:**

Kuadri i brendshëm rregullator në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit përfshin një tërësi aktesh me natyrë të përkohshme të lidhura me detyra specifike të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm. Llojet e akteve administrative në veprimtarinë e AKM-së, që përdoren për përmbushjen e funksioneve të saj, të cilësuara dhe në rregulloren e brendshme të AKM-së, janë:

1. “**Urdhëri**”, akti nënligjor i Drejtorit të Përgjithshëm me karakter të brendshëm, që vendos rregulla, sjellje të përgjithshme ose rregullon një marrëdhënie konkrete. Urdhëri del në bazë dhe në zbatim të ligjit ose Vendimit të Këshillit të Ministrave.
2. “**Rregullorja**”, është akt nënligjor i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, që shtjellon rregullat dhe procedurat që do të përdoren në kryerjen e një veprimtarie konkrete.

#### **Aktet me natyrë rregulluese të veprimtarisë së punës së AKM-së listohen, por pa u kufizuar, si më poshtë vijon:**

- Rregullore e brendshme Nr. 120 prot., datë 12.01.2021 për “Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit”;
- Urdhër Nr. 5247 prot., datë 29.10.2021 për “Ngritjen e njësisë së sinjalizimit të brendshëm”;
- Rregullore Nr. 5272 prot., datë 29.10.2021 për “Hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në AKM”;
- Rregullore Nr.5219., prot datë 12.07.2023 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”;
- Rregullore Nr. 5271 prot., datë 29.10.2021 për “Hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në AKM”;
- Urdhër Nr. 2773 prot., datë 07.04.2023 për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake e të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;

- Urdhër Nr. 2836 prot., datë 11.04.2023 për “Krijimin e komisionit teknik për verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A,B dhe licensave të nënkategorisë III.2.B”;
- Rregullore Nr. 2773/1 prot., datë 07.04.2023 mbi “Mënyrën e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes së komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- Rregullore Nr. 2836/1 prot., datë 11.04.2023 mbi “Mënyrën e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes së komisionit teknik për shqyrtimin e aplikimeve për leje mjedisi të tipit A,B dhe licensave të nënkategorisë III.2.B.”;
- Urdhër Nr. 86, datë 19.04.2023 për “Për një ndryshim në urdhërin Nr. 83, datë 14.04.2023 për ngritjen e Komisionit të Ankimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”;
- Rregullore Nr. 6144/1 prot., datë 09.08.2022 mbi “Mënyrën e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes nga komisioni i shqyrtimit të ankimeve administrative në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”;
- Urdhër i brendshëm Nr. 31, datë 13.02.2023 për “Caktimin e personit përgjegjës për prokurimin publik”;
- Urdhër Nr. 7, datë 18.01.2022 për “Caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit në AKM”.



## **MIRATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT**

Miratimi i Planit të Integritetit për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit përfaqëson vullnetin institucional për fuqizimin e mëtejshëm të integritetit institucional, transparencës dhe parandalimit të korrupsionit.

Ky dokument u hartua gjatë periudhës Maj - Korrik 2023 duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 334, datë 07.10.2021.

Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- Vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat kompromentojnë aftësinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në kryerjen e funksioneve të saj në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme;
- Vlerësimi i faktorëve të riskut;
- Hartimi i masave të përshtatshme për adresimin e risqeve të evidentuara.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të institucionit, të cilat përfshijnë: fushën e veprimit të sektorit juridik dhe të marrëdhënieve ligjore, menaxhimin financiar, menaxhimin e burimeve njerëzore, sigurimin e performancës mjedisore, vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin, inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

Plani i Integritetit për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit mbështetet në politikat e Qeverisë Shqiptare të orientuara drejt perspektivës për aderim në Bashkimin Evropian, të prezantuara nëpërmjet dokumenteve kyçe, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjia Ndër-sektoriale e Drejtësisë (SND), Strategjia e Luftës kundër Korrupsionit.

## **PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1. Ngritja e Grupit të punës në bazë të Urdhërit Nr. 111, datë 15.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”, Urdhërit Nr.130, datë 31.05.2023 për “Një shtesë në urdhërin nr.111 datë 15.05.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”, Urdhërit Nr. 152, datë 27.06.2023 “Për një ndryshim në urdhërin Nr.130, datë 31.05.2023”, Urdhërit Nr. 188, datë 08.08.2023 “Për një ndryshim në urdhërin Nr.130, datë 31.05.2023”;
2. Informimi i detajuar i punonjësve të institucionit mbi metodologjinë dhe aktivitetet e trajnimit e planifikuara për përgatitjen e planit të integritetit;
3. Vlerësimi fillestar i integritetit në të gjithë sektorët përkatës të institucionit;
4. Mbledhja e informacionit të nevojshëm të identifikimit, analizimit dhe vlerësimit të risqeve nga çdo sektor;
5. Shqyrtimi dhe analizimi i informacionit dhe i dokumentacionit të mbledhur lidhur me vlerësimin, ekspozimin dhe rezistencën e institucionit ndaj risqeve;
6. Hartimi i masave për trajtimin e risqeve të identifikuar me qëllim përmirësimin e integritetit;
7. Prioritizimi i masave zbatuese dhe rregullatore për minimizimin e risqeve;
8. Miratimi i planit të integritetit.

## **QASJA METODOLOGJIKE**

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në përputhje me MVRI, u përdorën:

Burime parësore dhe burime dytësore:

- Analizë për të evidentuar risqet e secilit sektor të çdo drejtorie,
- Analizë e kuadrit rregullator të brendshëm,
- Analizë e veprimtarisë së institucionit dhe e drejtorive përkatëse,
- Pyetësor vetëvlerësimi për punonjësit e institucionit sipas shtojcës 3 të “Metodologjia e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”.

## **OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2023-2024**

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Plani Integriteti, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka vendosur objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2023-2024, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara.

### **Objektivat strategjikë të Planit të Integritetit 2023-2024 janë:**

- 1.** Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe informimi periodik i punonjësve në lidhje me urdhërat dhe rregulloret për mbarëvajtjen institucionale dhe sjelljen e punonjësve të institucionit;
- 2.** Menaxhimi i aseteve dhe buxhetit të institucionit;
- 3.** Garantimi i transparencës me publikun;
- 4.** Menaxhimi i sektorit të kimikateve;
- 5.** Menaxhimi i sektorit të ankimimeve (apelim, ekzekutim dhe trajtim i penalteteve).

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

## **RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT**

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

**Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjesisë së institucionit, rezultoi se:**

Agjencia Kombëtare e Mjedisit u ristrukturua në zbatim të Urdherit të Kryeministrit Nr. 187, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”,

Sa më sipër, struktura e institucionit dhe vlerësimi i riskut sipas sektorëve është si më poshtë:

### **DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

- **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E ANKIMIMEVE (APELIM, EKZEKUTIM DHE TRAJTIM I PENALITETEVE)**

Funksioni i Sektorit të Ankimimeve (Apelimi, Ekzekutimi dhe Trajtim të Penaliteteve) është shqyrtimi i ankimimeve për masat administrative të vendosura ndaj subjekteve si mjet ligjor administrativ dhe ndjekja e procesit të ekzekutimit të detyrimeve monetare ndaj subjekteve të sanksionuara.

**Objektivat dhe detyrat kryesore të Sektorit të Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve) janë:**

- Shqyrtimi i hollësishëm dhe brenda afateve ligjore të ankimimeve të paraqitura për masat administrative të vendosura ndaj subjekteve në kuadër të aplikimit të përgjegjesisë mjedisore dhe sanksionimit të shkeljeve të legjislacionit mjedisor;
- Ndjekja me rigozitet e procesit të ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të sanksionuara deri në arkëtimin e plotë në favor të institucionit;
- Plotësimi i vazhdueshëm i databazës së kundërvajtjeve administrative me proceset e fundit të ardhura pranë sektorit, si dhe ecurinë e tyre;
- Bashkërendimi i punës me drejtoritë dhe Agjencitë Rajonale, lidhur me zbatimin e praktikave më të mira ligjore dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit mjedisor;
- Evidentimi i problematikave që dalin gjatë zhvillimit të punës, si propozimi i zgjidhjeve për këto problematika;
- Hartimi i metodikave apo parimeve të tjera shtesë, mbi të cilat mbështetet sektori mbi përcaktimin e vlerës së masave administrative, për rastet e kundërvajtjeve, për të cilat parashikohet i njëjti dënim;
- Të gjithë objektivat e mësipërme duhet të plotësohen duke zbatuar me korrektësi kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me mjedisin.

### **Vlerësimi i faktorëve të riskut**

Ankimimi Administrativ është një hallkë e rëndësishme e parashikuar në ligj si mjet ligjor për procesin e kundërshtimit të masës administrative përpara procedurës së ankimit në Gjykatë, e për

rrjedhje shqyrtimi i hollësishëm i ankimeve të subjekteve është një domosdoshmëri për vijueshmërinë e procesit.

Gjithashtu, një proces i rëndësishëm është dhe ndjekja e ekzekutimit të detyrimeve monetare ndaj masave administrative të formësuara në titull ekzekutiv deri në arkëtimin e tyre në llogarinë e institucionit.

### **Faktorët e riskut të identifikuar me procesin e punës në sektorin e ankimeve janë si më poshtë:**

- Koordinimi jo në kohë i punës me Agjencitë Rajonale të Mjedisit për raportimin e databazës së masave administrative, mund të sjellë paqartësi në lidhje me masat administrative të vendosura nga ARM-të.
- Vakancat në strukturën e sektorit (2 (dy) vende vakante), në periudhën kur numri i inspektimeve është i lartë, ngadalësojnë procesin e shqyrtimit të ankimit administrativ.
- Vonesa e gjykatës për nxjerrjen e Vendimit për titullin ekzekutiv vonon procesin e ekzekutimit të masave administrative.

### **Strategjitë potenciale për menaxhimin e riskut:**

- Krijimi i një kanali komunikimi praktik dhe të aksesueshëm për përditësimin dhe raportimin e databazës së ARM-ve në AKM.
- Kërkesë për informacion Gjykatës kur ka vonesa në lëshimin e urdhërave të ekzekutimit.

## **DREJTORIA E MENAXHIMIT DHE EDUKIMIT MJEDISOR**

- **Spektori i zbatimit të standardeve dhe metodologjive mjedisore**
- **Spektori i vlerësimit të gjendjes mjedisore**
- **Spektori i ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor**
  
- **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E ZBATIMIT TË STANDARDEVE DHE METODOLOGJIVE MJEDISORE**

Spektori është i përbërë nga 3 (tre) Specialist dhe Përgjegjësi i Sektorit. Specialisti raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit. Përgjegjësi i Sektorit përgjigjet para Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt para Drejtorit të Përgjithshëm.

### **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit përfshijnë:**

- Hartimin dhe monitorimin e zbatimit të standardeve dhe kriterëve mjedisore dhe të cilësisë së mjedisit.
- Hartimin e normativave mjedisore dhe monitorimin e impaktit dhe efikasitetin e tyre.
- Hartimin e praktikave dhe metodologjive, udhëzuesve dhe rregulloreve mbi mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit.
- Ndërmarrjen e masave për rishikimin dhe përmirësimin e standardeve, kriterëve dhe normave mjedisore sipas nevojës.
- Grumbullimin dhe sistemin e informacionit të sektorit për të përditësuar faqen zyrtare web të AKM-së.

- Rakordimin e punës me sektorë të tjerë si dhe strukturat e varësisë së AKM-së për zbatimin e detyrave që kërkojnë bashkëpunim.
- Mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e të gjithave aspekteve të sistemit të cilësisë sipas standardit ISO 17025 të Agjencisë.

Sektori i Zbatimit të Standardeve dhe Metodologjive bashkëpunon me të gjitha strukturat brenda institucionit për realizimin e objektivave dhe zgjidhjen e problemeve komplekse që ndikojnë në realizimin e tyre.

Niveli i riskut të korrupsionit në Sektorin e Përcaktimit të Standardeve dhe Metodologjive konsiderohet i ulët dhe i mesëm pasi ky sektor nuk ka procese apo struktura të ndjeshme dhe të ekspozuara direkte ndaj korrupsionit.

### **Vlerësimi i risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

### **Reputacional**

Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e të gjithave aspekteve të sistemit të cilësisë sipas standardit ISO 17025 të Agjencisë, në bashkëpunim me grupin vlerësues për ruajtjen e parametrave të akredituar, konsiderohet risk i mesëm.

Niveli i riskut për Vlerësimin e të dhënave marrë nga raportet e grumbulluara nga sektori i Vlerësimin të Gjendjes në Mjedis, përpunimi i tyre lidhur me standardet dhe metodologjinë për indikatorët mjedisor, konsiderohet risk i ulët.

### **Financiar**

Niveli i riskut financiar nga procesi i zbatimit të standardeve ISO 17025, trajnimet e ndryshme të stafit si dhe blerja e standardeve konsiderohet i ulët.

## **• VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E VLERËSIMIT TË GJENDJES MJEDISORE**

Sektori është i përbërë nga 3 (tre) Specialist dhe Përgjegjësi i Sektorit. Specialisti raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili përgjigjet para Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt para Drejtorit të Përgjithshëm.

### **Objektivat e sektorit dhe detyrat funksionale përfshijnë:**

- Vlerësimi i gjendjes në mjedis (cilësia e ujit, ajrit, tokës, zonave të mbrojtura e biodiversitetit etj);
- Identifikimi dhe vlerësimi i rolit të aktivitetit njerëzor (biznese, individë, komunitete, industri, zhvillime urbane) dhe natyrore (ngrohja globale, klima, erozioni, etj) mbi mjedisin;
- Grumbullimi i të dhënave mbi gjendjen e mjedisit;
- Hartimi, përgatitja dhe publikimi i Raportit të Gjendjes në Mjedis;

Bashkëpunon me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë Sektorit apo Drejtorisë, si dhe me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për marrjen e mendimeve dhe komenteve për Raportin e Gjendjes në Mjedis, për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që hasen në këtë dokument përpara se të publikohet. Publikimi kryhet në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të AKM-së dhe në formë të printuar (libër) i cili shpërndahet në ministritë e linjës dhe institucione të tjera. Duke

ndjekur kështu një proces transparent për informimin e publikut dhe qeverisjes vendore e qendrore mbi gjendjen e mjedisit dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes në mjedis dhe minimizimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor dhe natyror mbi mjedisin.

Përsa i përket mekanizmave të kontrollit, në kuadër të llogaridhënies të strukturat eprorë, ky sektor konsultohet me eprorët dhe strukturat përkatëse të specializuara në fushën brenda objektit të veprimtarisë së sektorit dhe raporton mbi mbarëvajtjen në fund të çdo procesi.

Si i tillë, niveli i riskut të korrupsionit në Sektorin e Vlerësimit të Gjendjes Mjedisore konsiderohet shumë i ulët pasi ky sektor nuk ka procese apo struktura të ndjeshme dhe të ekspozuara direkte ndaj korrupsionit.

### **Vlerësimi i risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

#### **Reputacional**

Sektorin e Vlerësimit të Gjendjes Mjedisore harton dhe përgatit Raportin e Gjendjes në Mjedis, i cili publikohet në faqen zyrtare web të AKM-së dhe është lehtësisht i aksesueshëm për publikun e gjerë, organizata joqeveritare, mediat, njësitë e qeverisjes vendore dhe qeverisjen qendrore. Në këtë kuadër, ky sektor kujdeset që të dhënat dhe informacioni mbi gjendjen e mjedisit dhe rolin të aktivitetit njerëzor dhe natyror të merren nga institucione publike dhe të jenë të besueshme e të sakta. Në RGJM vendoset burimi i informacionit për të qenë transparent dhe për të mos krijuar keqinterpretime. Sektorin kujdeset që të përfshijë rekomandime për përmirësimin e gjendjes në mjedis si dhe për minimizimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor dhe natyror në mjedis. Kjo, me qëllim që t'i shërbejë politikbërësve për ndërmarrjen e masave përmirësuese si dhe publikut të gjerë për ndërgjegjësimin e tyre në mbrojtje të mjedisit.

Qëllimi i gjithë këtij procesi është ruajtja e integritetit të institucionit në informimin e saktë të publikut dhe organeve qeverisëse mbi gjendjen e mjedisit dhe rolin të aktivitetit njerëzor e natyror. Niveli i riskut konsiderohet shumë i ulët.

#### **Financiar**

Niveli i riskut financiar nga procesi i vlerësimit të gjendjes në mjedis, rolin të aktivitetit njerëzor dhe natyror mbi mjedisin, grumbullimit të të dhënave, që përmbillet me përgatitjen dhe publikimin e RGJM-së, konsiderohet shumë i ulët.

## • **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E NDËRGJEGJËSIMIT DHE EDUKIMIT MJEDISOR**

Sektori i ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor është i përbërë nga Përgjegjësi i Sektorit dhe 3 (tre) Specialist. Specialisti i sektorit përgjigjet para Përgjegjësit të Sektorit lidhur me hartimin e ndërgjegjësimit mjedisor, informacioneve mbi përmbushjen e objektivave të caktuara në strategji, programe dhe projekte të hartuara nga ministria, ndërsa ky i fundit raporton te Drejtori i Drejtorisë lidhur me përcaktimin e objektivave mjedisor, kriteret si edhe treguesit e edukimit mjedisor. Drejtori i Drejtorisë përgjigjet direkt para Drejtorit të Përgjithshëm.

### **Objektivat e sektorit dhe detyrat funksionale përfshijnë:**

- Kryerjen e fushatave sensibilizuese të cilat lidhen me ndërgjegjësimin mjedisor;
- Drejtimin e fushatave sensibilizuese në lidhje me procesin e optimizimit dhe shfrytëzimit të mjedisit, në përputhje me parimet, prioritetet në përdorim dhe nevojat e vendit, si edhe me kriteret për ruajtjen, mbrojtjen e komponentëve të mjedisit dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore;
- Ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Marrjen pjesë aktive në përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore të lidhura me fushatën e sensibilizimit për mbrojtjen e mjedisit;
- Organizimin e fushatave sensibilizuese për mbrojtjen e mjedisit në shkolla, bashki, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Vlerësimin e kosto-përfitimeve ekonomike dhe sociale të përdorimeve të burimeve mjedisore;

Sektori i Ndërgjegjësimit dhe Edukimit Mjedisor bashkëpunon me nivelet e tjera institucionale të AKM-së, me Agjencitë Rajonale Mjedisore, me Institucione Arsimore, Vendore dhe Qëndrore për të arritur mbrojtjen e mjedisit dhe qëndrueshmërinë mjedisore, sensibilizimin, promovimin mbi rëndësinë e mjedisit duke nxitur pjesëmarrjen e grupeve të tjera të interesit. Për arritjen e qëllimit të ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe grupeve të ndryshme të interesit do të përgatiten manuale të ndryshme, databaza, informacione, statistika, trajnime etj. Gjithashtu, këto fushata ndërgjegjëse do të publikohen edhe në mënyrë elektronike në faqen e web-it të AKM-së për të patur një shtrirje më të gjerë, duke ndjekur kështu një proces transparent.

Niveli i riskut të korrupsionit në Sektorin e Ndërgjegjësimit dhe Edukimit Mjedisor konsiderohet i ulët pasi ky sektor ka vetëm për qëllim ndërgjegjësimin mjedisor dhe jo procese vendimmarrëse të cilat do kishin ndikim të drejtpërdrejtë.

### **Vlerësimi i risqeve**

Risqet që kemi konsideruar që mund të ndikojnë në performancën e sektorit dhe integritetin e institucionit janë si më poshtë vijon:

#### **Reputacional**

Sektori i Ndërgjegjësimit dhe Edukimit Mjedisor organizon fushata sensibilizuese me institucione publike dhe grupe të tjera të interesit duke përgatitur manuale të ndryshme, informacione, trajnime,



konferenca dhe më pas publikimin e tyre në faqen zyrtare të AKM-së. Gjithashtu, gjatë fushatave bëhen anketime për të adresuar problematikat dhe boshllëqet ligjore.

Qëllimi i këtij sektori është që t'iu vijë në ndihmë institucioneve publike për propozime për ndryshime ligjore duke i'u referuar Direktivave Europiane si dhe të gjitha grupeve të interesit për përmbushjen e objektivit kryesor mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin optimal të burimeve natyrore. Për arsytet e mësipërme niveli i riskut konsiderohet i ulët.

### **Financiar**

Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere, përgatitja e manualeve, databazave, trajnimeve, marrja e ambjenteve me qera për përgatitjen e fushatave, shpenzimet e dietave do të konsiderohen risk i ulët. Aftësia për të arritur që fushatat ndërgjegjësuere të jenë brenda parametrave të kostove të llogaritura si edhe për arritur cilësinë e kërkuar do të konsiderohet risk i ulët.

## **DREJTORIA E RREGJISTRAVE MJEDISOR, INOVACIONIT & ANALIZAVE LABORATORIKE**

- **Sektori i inovacionit dhe bashkëpunimit mjedisor**
  - **Sektori i informacionit, gis dhe regjistrave mjedisorë**
  - **Sektori i mostrimit dhe analizave laboratorike**
  - **Sektori i kimikateve**
- 
- **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E INOVACIONIT DHE BASHKËPUNIMIT MJEDISOR**

Sektori është i përbërë nga 2 (dy) Specialist dhe Përgjegjësi i Sektorit. Specialisti raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili përgjigjet para Drejtorit të Drejtorisë, lidhur me përgatitjen e raporteve për vlerësimin e situatave të veçanta në lidhje me vlerësimin e gjendjes së mjedisit, kryerjen e kërkimeve shkencore, inovacioneve dhe zhvillimin e teknologjive.

### **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit përfshijnë:**

- Bashkëpunon me Ministrinë, ARM-të, me organet e qeverisjes vendore dhe me institucionet monitoruese për hartimin e Projekt-Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit si dhe përcakton të dhënat që ato duhet të monitorojnë;
- Bashkëpunon me ekipe të veçanta të ngritura me pjesëmarrje nga institucione të tjera të vendit në lidhje me gjendjen e mjedisit dhe propozon marrjen e masave të veçanta të ndërhyrjes për minimizimin/evitimin e riskut mjedisor;
- Përcakton TMD-të (Teknikat më të mira të disponueshme) dhe PMM-në (Praktikat më të mira mjedisore);
- Propozon mënyrat e implementimit të teknologjive inovative që kanë një impakt sa më të vogël mjedisor;
- Merret me kryerjen e kërkimeve shkencore, risive dhe zhvillimin e teknologjive;
- Vlerëson situatat e veçanta sikurse ka rezultuar nga analizat e laboratorit;
- Përgatit pjesë të raportit të monitorimit periodik të AKM-së dhe koordinon punën me ARM-të për monitorimin e mjedisit;
- Përgatit raportin e vlerësimit dhe sugjerimet për masat e ndërhyrjes për menaxhimin e riskut.

Publikimi i PKMM-së kryhet në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të AKM-së. Duke ndjekur kështu një proces transparent për informimin e subjekteve kontraktuese mbi lidhjen e kontratave për monitorimin e treguesve mjedisor.

### **Vlerësimi i risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

### **Reputacional**

Sektori i Inovacionit dhe Bashkëpunimit Mjedisor harton dhe përgatit Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, i cili publikohet në faqen zyrtare web të AKM-së dhe është lehtësisht i aksesueshëm për publikun e gjerë, organizata joqeveritare, mediat, njësitë e qeverisjes vendore dhe qeverisjen qendrore. Ky sektor harton çdo vit PKMM-në, si mjet i vlerësimit të gjendjes dhe cilësisë së mjedisit në tërësi. Të dhënat e monitorimit pas përpunimit, paraqiten në Raportin e Gjendjes së Mjedisit të vitit respektiv. Monitorimi mjedisor bazohet në zbatimin e metodologjisë DSPIR e cila përbën një rrjet analizash të mundshme për të zhvilluar strategjitë menaxhuese në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Monitorimi kryhet sipas disa kriterëve shkencorë përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizës së mostrave, në mënyrë tradicionale si dhe me anë të përdorimit të sensorëve automatikë (insitu) (biosensorëve) deri në përcjelljen e të dhënave në kohë reale (on line) në largësi (remote monitoring). Në këtë kuadër, ky sektor kujdeset që të dhënat dhe informacioni mbi gjendjen e mjedisit dhe rolit të aktivitetit njerëzor dhe natyror të merren nga institucione publike dhe të jenë të besueshme e të sakta.

Qëllimi i gjithë këtij procesi është ruajtja e integritetit të institucionit në informimin e saktë të publikut dhe organeve qeverisëse mbi gjendjen e mjedisit dhe rolit të aktivitetit njerëzor e natyror. Niveli i riskut konsiderohet shumë i ulët.

### **Financiar**

Niveli i riskut financiar nga procesi i hartimit të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit deri tek monitorimi i treguesve mjedisor konsiderohet shumë i ulët.

## **• VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E INFORMACIONIT, GIS DHE REGJISTRAVE MJEDISORE**

Sektori është i përbërë nga 5 (pesë) specialiste dhe përgjegjësi i sektorit.

### **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit përfshijnë:**

- Zhvillon, mirëmban dhe menaxhon Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) dhe EIMS (sistemin e informacionit mjedisor);
- Grumbullon dhe validon të dhënat dhe raportet mjedisore;
- Siguron dhe vë në dispozicion informacion mjedisor sipas bazës së të dhënave;
- Propozon mënyrat dhe mjetet për implementimin e tyre;
- Krijimi i hartave dhe grafikët, duke përdorur software GIS dhe pajisjet e lidhura me to;
- Njihet me kërkesat dhe nevojat për të dhëna, që kanë përdoruesit, për projekte dhe aplikacione të ndryshme;
- Mbledh, analizon dhe integron të dhëna hapësinore nga stafi dhe përcakton mënyrën më të mirë të shfaqjes së informacionit duke përdorur GIS;

- Përpilon të dhënat gjeografike nga burime të ndryshme duke i'u referuar regjistrimeve, vëzhgimin në terren, imazhet satelitore, fotografi ajrore, dhe harta ekzistuese;
- Vlerësimin e të dhënave të ndryshme mjedisore, planifikimin dhe hartimin e programit të raportimit;
- Bashkëpunon ngushtë me ekspertët IT dhe PRTR dhe mbështet punën nëse është e nevojshme;
- Harton dhe bëhet pjesë në projekte zhvillimore me karakter studimor dhe shkencor;
- Konfiguron hartat dhe metodat e tjera të prezantimit të të dhënave që kanë referenca hapësinore, duke përdorur sistemin GIS;
- Krijimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve.
- Vlerësimi i të dhënave dhe metodologjive me qëllim ngritjen, mirëmbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e regjistrave mjedisore (PRTR-it, GHG, LRTAP, mbetje etj) dhe përmbushja e objektivave të drejtorisë;
- Vlerësimin e treguesve të databazave dhe përgatitjes së raporteve periodike të mjedisit.

### **Vlerësimi i risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

#### **Reputacional**

Sektori i Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisore, krijon dhe mirëmban Regjistrin e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve i cili publikohet në faqen zyrtare web të AKM-së dhe është lehtësisht i aksesueshëm për operatorët që përditësojnë të dhënat e tyre për aktivitetin që ushtrojnë. Në këtë kuadër, ky sektor kujdeset që të dhënat dhe informacioni në këto regjistra të jenë sa më të besueshme e të sakta.

Qëllimi i gjithë këtij procesi është ruajtja e integritetit të institucionit në informimin e saktë të publikut dhe organeve qeverisëse mbi shkarkimet dhe transferimet e ndotësve që subjektet ushtrojnë nga aktivitetet e tyre.

#### **Financiar**

Niveli i riskut financiar nga mirëmbajtja dhe menaxhimi i Sistemit të Informacionit Gjeografik; nga procesi i vlerësimit të të dhënave të ndryshme mjedisore, planifikimi dhe hartimi i programit të raportimit; grumbullimi dhe validimi i të dhënave të raporteve mjedisore si dhe krijimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve konsiderohet i moderuar si mungesë/kufizime buxheti për të kryer proceset themelore të institucionit.

### **• VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E MOSTRIMIT DHE ANALIZAVE LABORATORIKE**

Sektori është i përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) Specialist dhe Përgjegjësi i Sektorit.

#### **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit përfshijnë:**

- Udhëheq dhe menaxhon punën për kryerjen e analizave në laborator dhe punën e ekipit të mostrimit;
- Laboratori i AKM-së kryen monitorimin e gjendjes në mjedis nëpërmjet analizave si dhe siguron përmbushjen e kritereve të akreditimit;

- Kujdeset për mbarëvajtjen e sistemit të cilësisë dhe zgjerimin e tij sipas nevojave, duke implementuar kërkesat e Menaxherit të Cilësisë dhe duke caktuar një Menaxher Teknik;
- Përgatit dhe dërgon raporte në përputhje me monitorimet që realizon laboratori dhe sistemi i menaxhimit të cilësisë sipas nevojave të punës;
- Bashkëpunon me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë Sektorit apo Drejtorisë duke siguruar që analizat laboratorike të kryhen sipas metodave të certifikuara ose ato të validuara si për procedurat e mostrimit dhe procedurat e analizave që përdoren nga Stafi i Laboratorit;
- Mundëson aplikimin e programeve që sigurojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë brenda ekipit, duke përfshirë marrjen parasysh edhe të testimit të aftësive, nëpërmjet testeve ndërkombëtare të zotësisë duke dalë me rezultate të kënaqshme që nga viti 2011.
- Përgatit raporte mujore ose edhe raporte për gjendje të jashtëzakonshme duke i publikuar ato në rrjetet sociale të AKM-së ose në faqen zyrtare web, duke ndjekur kështu një proces transparent për informimin e publikut dhe qeverisjes vendore e qendrore mbi gjendjen e mjedisit dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes në mjedis .

### **Vlerësimi i risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit të sektorit, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

### **Reputacional**

Sektori i Mostrimit dhe Analizave Laboratorike kryen monitorimin e gjendjes në mjedis nëpërmjet analizave si dhe siguron përmbushjen e kriterëve të akreditimit dhe për cilësinë e ajrit që nuk është i akredituar, vepron sipas manualeve të cilësisë së pajisjeve të ajrit duke siguruar mirëmbajtje dhe kalibrim të pajisjeve në frekuencë dhe kohë të përcaktuar.

Sektori i Mostrimit dhe Analizave Laboratorike harton dhe përgatit raporte të ndryshme së Gjendjes në Mjedis, të cilat publikohen në faqen zyrtare të AKM-së dhe është lehtësisht i aksesueshëm për publikun e gjerë, organizata joqeveritare, mediat, njësitë e qeverisjes vendore dhe qeverisjen qendrore.

Në këtë kuadër, ky sektor kujdeset që të dhënat e monitoruara të jenë të sakta dhe të besueshme duke ndjekur të gjitha hallkat e sistemit të menaxhimit, si edhe për cilësinë e ajrit duke ndjekur të gjitha hallkat e manualeve të përdorimit të pajisjeve në mënyrë të tillë që informacioni mbi gjendjen e mjedisit dhe rolin të aktivitetit njerëzor dhe natyror të merren nga institucione publike dhe të jenë të besueshme e të sakta.

Sektori kujdeset që të përfshijë rekomandime për përmirësimin e gjendjes në mjedis si dhe për minimizimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor dhe natyror në mjedis. Kjo, me qëllim që t'i shërbejë politikbërësve për ndërmarrjen e masave përmirësuese si dhe publikut të gjerë për ndërgjegjësimin e tyre në mbrojtje të mjedisit.

Qëllimi i gjithë këtij procesi është ruajtja e integritetit të institucionit në informimin e saktë të publikut dhe organeve qeverisëse mbi gjendjen e mjedisit dhe rolin të aktivitetit njerëzor e natyror. Niveli i riskut konsiderohet i ulët.

### **Financiar**

Niveli i riskut financiar nga sektori laboratorit i cili kryen monitorimin e gjendjes në mjedis nëpërmjet analizave si dhe siguron përmbushjen e kriterëve të akreditimit. Për cilësinë e ajrit që nuk është i akredituar vepron sipas manualeve të cilësisë së pajisjeve të ajrit duke siguruar mirëmbajtje dhe kalibrim të pajisjeve në frekuencë dhe kohë të përcaktuar, vlerësimi të gjendjes

në mjedis, rolit të aktivitetit njerëzor dhe natyror mbi mjedisin, që përmbillet me përgatitjen e raporteve të ndryshme të gjendjes së mjedisit, konsiderohet i ulët.

## • **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E KIMIKATEVE**

Sektori ka në strukturë 3 (tre) specialistë dhe 1 (një) përgjegjës.

### **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit janë:**

- Realizon mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e informacionit lidhur me vlerësimin/analizimin e kimikateve dhe trajtimin e tyre;
- Përgatitja e legjislacionit sekondar;
- Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave dhe bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Pjesëmarrje në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me fushën e kimikateve;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar lidhur me menaxhimin e kimikateve;
- Përgatitja e procedurave, krijimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit Kombëtar të Kimikateve;
- Shërbimin e informacionit (helpdesk) për të ofruar këshilla për prodhuesit, importuesit, përdoruesit e tjerë dhe çdo palë tjetër të interesuar për përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre përkatëse në bazë të këtij ligji;
- Informimin e publikut të gjerë në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për rreziqet që vijnë nga kimikatet kur konsiderohet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit;
- Plotësimi i detyrimeve lidhur me konventat dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për menaxhimin e kimikateve (Konventa e Stokholmit, Konventa e Roterdamit, protokollet e CLRTAP-it).

### **Vlerësimi i risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit të sektorit, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

### **Reputacional**

- Koordinimi me strukturat e përfshira në plotësimin e detyrimeve në zbatim të ligjit nr.27/2016 për “Menaxhimi i Kimikateve në Shqipëri” në lidhje me grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave në lidhje me Regjistrin Kombëtar të Kimikateve, hartimi i legjislacionit sekondar në lidhje me mirëfunksionimin e RKK. Ky risk vlerësohet si risk ligjor i përputhshmërisë, pasi kërkesa që ka ligji Nr.27/2016 për “Menaxhimi i Kimikateve në Shqipëri”, për krijimin e RKK, akoma nuk është operacional dhe kërkon një koordinim midis strukturave përgjegjëse të përfshira në krijimin dhe mbarëvajtjen e RKK. Ky risk vlerësohet si risk i mesëm me impakt për integritetin e Sektorit të Kimikateve.
- Shërbimin e informacionit (helpdesk) për të ofruar këshilla për prodhuesit, importuesit, përdoruesit e tjerë dhe çdo palë tjetër të interesuar për përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre në lidhje me menaxhimin e kimikateve, ku risk të brendshëm përbën përpunimi i informacionit për t'u publikuar në web, kontrolli i informacionit të publikuar, caktimi i informacionit të ri që duhet të publikohet. Ky risk vlerësohet si risk reputacional, megjithëse publikimi i informacionit ka pasur ndikim pozitiv për publikun që ka patur interes të marrë informacione shtesë. Me publikimin e vazhdueshëm të informacionit nga sektori, ky risk është minimizuar shumë ose është eliminuar.

## **Financiar**

Pjesëmarrja në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me fushën e kimikateve është një risk i vlerësuar si operacional në lidhje me kërkesat që ka plotësimi i detyrave për pjesëmarrje në trajnime dhe takime teknike për rritje të kapaciteteve teknike sektoriale. Sektori ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme në të shkuarën dhe ka detyrë ndjekjen e të gjitha takimeve ndër-institucionale brenda dhe jashtë vendit. Për të përmirësuar këtë risk, është bërë koordinimi dhe caktimi i personave përgjegjës për pjesëmarrje, vlerësimi për mundësi financimi për pjesëmarrje nga institucioni kur ka qenë e nevojshme duke u koordinuar me Drejtorinë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse për pjesëmarrje. Ky risk vlerësohet i ulët dhe për përmirësimin e tij do të bashkëpunohet me projektet financuese mbështetëse për të siguruar pjesëmarrjen në takime si dhe do të krijohet mundësia për mbështetje financiare nga institucioni dhe drejtoria përkatëse.

### **Strategjitë për menaxhimin e riskut:**

- Për të evituar riskun sipas kërkesave të ligjit Nr.27/2016 për “Menaxhimi i Kimikateve në Shqipëri” sektori ka si objektiv krijimin dhe mbarëvajtjen e RKK, i cili është një proces që ka nisur dhe me suportin e MTM dhe projektit me ekspertë nga Agjencia Suedeze e Kimikateve.

## **DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM-VE**

- Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
  - Sektori i Lejeve Mjedisore
  - Sektori i Monitorimeve të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve
  - Sektori i Përgjegjësive Mjedisore dhe Vlerësimit të Riskut
- **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E MONITORIMEVE TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM-VE**

Sektori i monitorimeve të lejeve mjedisore dhe VNM-ve ka në strukturë 5 (pesë) specialist dhe përgjegjës të sektorit.

### **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit janë:**

- Harton kthim përgjigje me anë të shkresës zyrtare për personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekte të lejes që dorëzojnë dokumentacion mbi zbatimin e kriterëve dhe kushteve të lejes;
- Ndjek përditësimin e të dhënave në databazën përkatëse të operatorëve;
- Harton informacione në lidhje me subjektet e licensuara, të cilët nuk kanë raportuar, sipas kushteve dhe parimeve të lejes mjedisore dhe i'a paraqet Përgjegjës të Sektorit;
- Bashkërendon punën me sektorët e drejtorisë për kontrollin e subjekteve, të cilët nuk kanë raportuar;
- Harton dhe ndjek realizimin e detyrave të parashikuara në planet mujore dhe vjetore të punës së sektorit, duke evidentuar problemet që dalin, si dhe sugjeron dhe propozon zgjidhje të eprori i tij;
- Kontrollon dhe verifikon dokumentacionin dhe raportet e vetëmonitorimit në përputhje me kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti, si dhe përditëson regjistrin e dokumentacionit dhe raporteve të vetëmonitorimit sipas formatit të miratuar;

- Bashkërendon punën me sektorët e drejtorisë për kontrollin e subjekteve, të cilët nuk kanë raportuar;
- Harton dhe ndjek realizimin e detyrave të parashikuara në planet mujore dhe vjetore të punës së sektorit, duke evidentuar problemet që dalin, si dhe sugjeron dhe propozon zgjidhje të eprorët e tij;
- Kërkon plotësimin të dokumentacionit apo informacionit shtesë në rastet kur operatorët e pajisur me leje mjedisore të Tipit A ose B nuk kanë zbatuar kushtet e lejes dhe nuk kanë dorëzuar dokumentacionin sipas Aneksit 1 të Urdhërit nr.126, datë 10.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm.
- Regjistrimi i planit të mostrimit të miratuar nga operatorët për parametrat e shkarkimit për vitin pasardhës, ku përcaktohet data/muaji/viti/ora dhe vendi i marrjes së mostrave.

## **Vlerësimi i riskut**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit të sektorit, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

### **Reputacional**

Sektori i monitorimeve të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve harton informacione në lidhje me subjektet e licensuara, të cilët nuk kanë raportuar, sipas kushteve dhe parimeve të lejes mjedisore dhe i'a paraqet drejtorit të drejtorisë, kontrollon dhe verifikon dokumentacionin dhe raportet e vetëmonitorimit në përputhje me kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti, si dhe përditëson regjistrin e dokumentacionit dhe raporteve të vetëmonitorimit sipas formatit të miratuar. Ndjek mirëmbajtjen dhe përditësimin e databazës së të dhënave (dokumentacionit) që dorëzojnë personat fizikë dhe juridikë, subjekt të lejes mjedisore;

Në këtë kuadër, ky sektor menaxhon dokumentacionin e dërguar nga personat fizikë dhe juridikë veprimtaritë e të cilëve janë subjekte të lejes; Përditësimi me të dhëna për raportime për operatorët e pajisur me leje të tipit A dhe B, të cilët dorëzojnë dokumentat dhe raportet e vetëmonitorimit mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore.

Qëllimi i gjithë këtij procesi është ruajtja e integritetit të institucionit në informimin e saktë të publikut dhe organeve qeverisëse mbi raportimin e monitorimit të lejeve të mjedisit dhe VNM-ve të dorëzuara nga subjektet.

### **Financiar**

Niveli i riskut financiar nga procesi i monitorimit të raporteve të lejeve të mjedisit dhe VNM; Përditësimi me të dhëna për raportime për operatorët e pajisur me leje të tipit A dhe B, të cilët dorëzojnë dokumentat dhe raportet e vetëmonitorimit mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore, rezulton të konsiderohet shumë i ulët.

## • **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E PËRGJEGJËSIVE MJEDISORE DHE VLERËSIMIT TË RISKUT**

**Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit të përgjegjësive mjedisore dhe vlerësimit të riskut janë:**

- Parandalon dhe rekupeon dëmet që i shkaktohen mjedisit, në bazë të Parimit “Ndotësi Pague”;
- Marrja e masave për rehabilitimin e mjedisit;
- Prezanton planin e masave dhe praktikave që synojnë minimizimin e rrezikut të dëmtimit të mjedisit;
- Prioritet i sektorit të përgjegjësive mjedisore dhe vlerësimit të riskut është vlerësimi i realizimit/përfundimit të rehabilitimit mjedisor për lejet e kërkim-zbulimit në bashkëpunim me Sektorin e Inspektimit Mjedisor në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës;
- Vlerësimi për realizimin/përfundimin e rehabilitimit mjedisor për lejet e shfrytëzimit në bashkëpunim me Sektorin e Inspektimit Mjedisor në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës;
- Identifikimi i faktorëve të riskut (mos respektimi i kushteve të lejes, operimi në paligjshmëri, shkarkimet më të larta se referencat ligjore të bëra në mjedis) për të përcaktuar gjendjen mjedisore dhe objektivat për përmirësimin e situatës;
- Trajtimin dhe kthimin e përgjigjeve të shkresave zyrtare të ardhura nga subjekte që kanë pasur raste incidentesh deri në sigurimin e kompesimit për dëmin e shkaktuar;
- Të azhurnojë databazën me të dhënat për operatorët e licensuar që e kanë detyrim ligjor për të dorëzuar planet e rehabilitimit dhe cilat janë në proces dorëzimi;
- Të azhurnojë databazën ku janë regjistruar subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për inertet lumore nga viti 2012 e në vazhdim;
- Tabela e subjekteve të licensuara dhe të pajisur me leje mjedisore që janë të regjistruar për kryerjen, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore;
- Tabela për subjektet e licencuara dhe të pajisura me leje mjedisore të cilat ushtrojnë veprimtarinë për prodhimin, përpunimin, grumbullimin dhe riciklimin e letrës, kartonit, plastikës;
- Tabela për asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve me metodën rendering;
- Tabela e subjekteve të licensuar që operojnë në fushën e trajtimit të mbetjeve urbane;
- Tabela për subjektet që gjenerojnë mbetje teknologjike;
- Tabela përmbledhëse për subjekte të pajisura me leje mjedisi tipi A dhe B për të cilat është bërë kodifikimi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;
- Tabela përmbledhëse për subjekte të pajisura me Licencë III.2.B për të cilat është bërë kodifikimi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

### **Vlerësimi i riskut**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:



## **Reputacional**

Duke qënë se ky sektor harton informacione në lidhje me subjektet e licensuara dhe të pajisur me leje mjedisore që janë të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë për prodhimin, përpunimin, grumbullimin dhe riciklimin e letrës, kartonit, plastikës, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, gurore, për asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve me metodën rendering, mbetjeve urbane, mbetjeve teknologjike, kodifikimi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, gjithmonë angazhohet të jetë sa më i përpiktë në mënyrë të tillë që informacioni i përcjellë të jetë i saktë.

## **Financiar**

Detyra funksionale e sektorit të Përgjegjësisë Mjedisore dhe Vlerësimit të Riskut që lidhet me përditësimin me të dhëna për raportime për operatorët e pajisur me leje të tipit A dhe B, nuk konsiderohet me risk financiar.

## **• VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E LEJEVE MJEDISORE**

Sektori i lejeve mjedisore e kryen gjithë veprimtarinë në zbatim të kuadrit ligjor mjedisor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe duke respektuar të gjitha afatet e vendosura në dispozitat ligjore.

### **Objektivat dhe detyrat funksionale janë:**

- Zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me mjedisin;
- Ndjekja me rigorozitet i procedurës së shqyrtimit të aplikimeve për leje mjedisore deri në vendimmarrje, zbardhje të akteve të miratimit apo refuzimit të këtyre çështjeve;
- Azhornimi ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- Kthimi i përgjigjes për shkresat zyrtare për operatorët e pajisur me leje mjedisore dhe licenca III.2.B;
- Mbajtja e protokolleve të komisioneve të shqyrtimit të aplikimeve të lejeve mjedisore;
- Krijimin e një baze të dhënash të përditësuar për të gjitha proceset e ndjekura;
- Ndjekja dhe zbatimi i akteve ligjore që kanë të bëjnë me lejet mjedisore;
- Ndjekja dhe zbatimi i akteve ligjore që kanë të bëjnë me procedurat e lejet e tipit A, B dhe zhvillimin e komisionit të lejeve mjedisore;
- Përgatitja e zbardhjeve dhe ngarkimi në QKB të Akteve të Miratimit dhe Refuzimit të Lejeve Mjedisore;
- Shkarkimi i dosjeve të ardhura nga QKB (aplikimet për leje tipi A,B dhe III.2.B) të cilat i dërgohen në mënyrë elektronike ARM-ve dhe MTM-së;
- Mbajtja e korrespondencave me drejtoritë teknike të Ministrisë para marrjes në shqyrtim të dosjeve;
- Kthimin e përgjigjeve të shkresave zyrtare dhe ankesave të paraqitura;
- Propozon projekte për akte nënligjore për drejtimet që mbulon;
- Ndjek dhe koordinon punën për marrjen e komenteve, sugjerimeve për lejet që lëshon Agjencia.

### **Vlerësimi i riskut**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

## **Reputacional**

Referuar detyrave funksionale të sektorit për hartimin, prezantimin e dosjes në lidhje me aplikimet e subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje mjedisi tipi A,B ose licenca III.2.B; hartimin e aktit të miratimit ose të refuzimit për dosjet e aplikimeve të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje mjedisi tipi A,B ose licenca III.2.B, mbajtja e databazës së aplikimeve të cilat vijnë nëpërmjet QKB-së;

Sektori angazhohet që me qëllim ruajtjen e integritetit të institucionit në informimin e saktë të publikut dhe organeve qeverisëse mbi aplikimet dhe kërkesën e subjekteve për t'u pajisur me leje mjedisi tipi A,B dhe licenca III.2.B të jetë sa më i saktë dhe për rrjedhojë niveli i riskut konsiderohet i ulët.

## **Financiar**

Niveli i riskut financiar nga procesi i shqyrtimit të aplikimit, miratimit apo refuzimit për pajisjen me leje mjedisore tipi A, B ose license III.2.B, përditësimi me të dhëna për aplikimin e operatorëve që kërkojnë të pajisen me leje mjedisi të tipit A, B, rezulton të konsiderohet i ulët.

## **• VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

Sektori i VNM-së pranë Drejtorisë së Vlerësimit të Impaktit dhe Licensimit, e ushtron funksionin administrativ, në bazë të të gjithë legjislacionit mjedisor në fuqi duke respektuar afatet e vendosura në ligj.

### **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit janë:**

- Ndjek procedurat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, për aktivitetet që i nënshtrohen këtij procesi;
- Propozon projekte për akte nënligjore në lidhje me vlerësimin mjedisor;
- Sektori i VNM-së, merret me hartimin e akteve ligjore e nënligjore, lidhur me procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sidomos në procedurat e Konsultimit me Publikun dhe përmirësimin e infrastrukturës së aplikimit të dosjeve për VNM;
- Shqyrton aplikimin dhe merret me hartimin e aktit të miratimit ose refuzimit të VNM-së.

## **Vlerësimi i riskut**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

### **Reputacional**

Sektori i VNM-së punon me sistemin e aplikimeve nëpërmjet e-albania. Porta hyrëse është e-albania, më pas aplikimi përcillet nga MTM. Nëse sistemi hakërohet, nuk punon, rrezikohet mbarëvajtja e punës, ruajtja e dosjeve të cilat janë të ngarkuara në sistem. Si pasojë, rrezikohet procesi i punës dhe ruajtja e aplikimeve.

Sipas rrethanave, punonjësit mund të ndodhen në një situatë konflikti interesi, e cila në disa raste mund të barazohet me korrupsionin pasiv. Misioni profesional i çdo bashkëpunëtori është që nuk duhet të hyjë në konflikt me interesin e tij personal. Nëse paraqitet një situatë e tillë, bashkëpunëtori në fjalë duhet të informojë menjëherë për këtë eprorin e tij direkt.

Në mënyrë të përgjithshme, çdo bashkëpunëtor që mund të ndodhet në një situatë dyshimi në lidhje me sjelljen që duhet të mbajë, duhet të respektojë parimin bazë të transparencës.

## **Financiar**

Niveli i riskut financiar nga procesi i shqyrtimit të aplikimit, miratimit apo refuzimit për pajisjen me aktin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, përditësimi me të dhëna për aplikimin e operatorëve që kërkojnë të pajisen me aktin e vlerësimit të ndikimit në mjedis rezulton që të konsiderohet i ulët.

## **DREJTORIA E INSPEKTIM-KONTROLLIT**

- **Sektori i inspektimit mjedisor**
- **Sektori i inspektimit të burimeve natyrore (ujërave)**
  
- **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E INSPEKTIMIT NË MJEDIS DHE SEKTORIN E BURIMEVE NATYRORE (UJËRAVE)**

**Sektori i Inspektimit në Mjedis** është i përbërë nga 15 (pesëmbëdhjetë) inspektorë, 2 (dy) specialistë dhe Përgjegjësi i Sektorit. Inspektori dhe specialisti raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili përgjigjet para Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt para Drejtorit të Përgjithshëm.

**Sektori i Burimeve Natyrore (Ujërave)** është i përbërë nga 7 (shtatë) inspektorë dhe Përgjegjësi i Sektorit. Inspektori raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili përgjigjet para Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt para Drejtorit të Përgjithshëm.

## **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit të inspektimit në mjedis dhe burimeve natyrore (ujëra) përfshijnë:**

- Sigurimi i kontrollit shtetëror, i mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin mjedisor në fuqi;
- Sigurimi, zbatimi dhe kontrolli i gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë gjithë veprimtarinë, në fushën e inspektimit të mjedisit;
- Sigurimi i kontrollit shtetëror, i mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionet në fuqi;
- Sigurimi, zbatimi dhe kontrolli i gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë gjithë veprimtarinë, në fushën e inspektimit të ujërave.

Sektorët e kësaj drejtorie bashkëpunojnë me të gjitha strukturat jashtë Sektorit apo Drejtorisë, me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Inspektoratin Shtetëror pasi Drejtoria e Inspektim-Kontrollit kryen inspektime në bazë të një programi tematik mbi bazë risku të miratuar nga Ministri.

Përsa i përket mekanizmave të kontrollit, në kuadër të llogaridhënies të strukturat eprorë, sektorët konsultohen me eprorët dhe strukturat përkatëse të specializuara në fushën brenda objektit të veprimtarisë së sektorëve dhe raportojnë mbi mbarëvajtjen në fund të çdo procesi.

## **Vlerësimi i risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

## **Reputacional**

Referuar detyrave dhe objektivave që kanë sektorët e Drejtorisë së Inspektim-Kontrollit niveli i riskut reputacional konsiderohet i ulët pasi këta sektorë kryejnë procesin e inspektimit nëpërmjet sistemit online e-inspektimi, kjo për arsye që të mos ketë ekspozim direkt ndaj korrupsionit si dhe për transparencë gjatë këtij procesi të mbajtur në vendin e inspektimit.

## **Financiar**

Referuar detyrave funksionale të Sektorit të Inspektimit në Mjedis dhe Sektorit të Burimeve Natyrore (Ujërave) për kryerjen e kontrollit tek operatorët që disponojnë leje mjedisi tipi A dhe B, inspektorët përdorin logjistikën e institucionit që përfshin përdorimin e mjeteve të transportit dhe karburantit për lëvizjen e tyre.

Gjithashtu, për dietat e udhëtimit të inspektorëve, sektori i financës dhe buxhetit parashikon që në fillim të vitit buxhetin e posaçëm dhe risku financiar konsiderohet i mesëm.

## **DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

- **Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse**
- **Sektori i Financës dhe Buxhetit**
- **Sektori Juridik dhe i Marrëdhënieve Ligjore**
- **VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse** ka si detyrë funksionale procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore, rekrutimin dhe përzgjedhjen e stafit nëpërmjet një procesi transparent, identifikimin e nevojave për rritjen profesionale të stafit, si dhe zbatimin e kodit të sjelljes dhe etikës në institucion, me qëllim krijimin e vlerave të qëndrueshme, drejtimin strategjik të politikave dhe planeve, si dhe efikasitetin në kryerjen e detyrave, që të mund të realizohet misioni i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

### **Objektivat dhe detyrat kryesore të sektorit:**

- Drejton procesin e procedurave të punësimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe 4 (katër) Agjencitë Rajonale të Mjedisit, duke siguruar një proces objektiv, transparent dhe të hapur.
- Mbështet procesin e ngritjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, nxit përkushtimin e stafit në kryerjen e detyrave funksionale.
- Ndjek plotësimin e librezave të punës dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve të pozicionit të punës së stafit.
- Siguron, përgatitjen dhe administrimin e vlerësimeve vjetore të stafit, si dhe asiston dhe bashkëpunon me drejtorët e drejtorive për realizimin e vlerësimeve individuale, konfirmimin e nëpunësve dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit.
- Ndjek procesin e procedurave disiplinore të punonjësve, përgatit urdhërat e emërimit, lirimit, kontratave të punës, si dhe kryerjen e lejeve vjetore të stafit.
- Harton dhe ndjek praktikatat e standardizuara të menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe sipas rastit, monitoron zbatueshmërinë e urdhërave të titullarëve.
- Kryen kontrollin e njësive të burimeve njerëzore në institucionet e varësisë, si dhe këshillon titullarët.

- Ndjek dhe koordinon punën për përfundimin e praktikave dokumentare, si dhe udhëheq procesin e ristrukturimit dhe reformimit të strukturave të burimeve njerëzore për përmirësimin e zbatimit të politikave të burimeve njerëzore.
- Vlerëson, aftësitë dhe performancën e përgjithshme të specialistëve të sektorit, duke përgatitur vlerësimet me shkrim të rezultateve në punë, duke diskutuar ecurinë dhe duke theksuar fushat në të cilat janë të nevojshme të bëhen përmirësime.
- Siguron ndjekjen e respektimit të orarit të punës, disiplinës dhe etikës në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
- Mban kontakte me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe dokumentacione të ndryshme.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është një fushë e rëndësishme, e cila kërcënohet nga risqe me ndikime negative për institucionin. Ato mund të hasen në aspekte dhe etapa të ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore si emërimi, zgjedhja, transferimi, largimi i personelit nga puna, miratimi, zbatimi apo ndryshimi i strukturës organizative, i rregulloreve, kodeve të ndryshme etj. të cilat mund të çojnë integritetin e institucionit duke ndikuar drejtëpërdrejtë në mirëfunksionimin e tij. Riorganizimi dhe përshtatja e vazhdueshme organizative janë procese të nevojshme në interes të rritjes së efikasitetit. Pas analizës së bërë në lidhje me procesin e rekrutimit në strukturat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, punonjësit rekrutohen dhe administrohen bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për nëpunësin civil, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Departamenti i Administratës Publike.

Një risk i mundshëm në lidhje me shërbimet mbështetëse paraqitet nga mospërditësimi i regjistrimit të mjeteve të transportit në inventar dhe aktiveve për pronat/objektet në inventar, duke pasqyruar në vijimësi ndryshimet që ndodhin siç mund të jenë për ndryshim përgjegjësie administrimi, ndryshim pronësie, shitje e privatizim.

Disa nga risqet që lidhen me menaxhimin e automjeteve në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë:

- Përdorimi i automjeteve nga personeli në mungesë të dokumentacionit standard justifikues për disiplinimin e lëvizjes së automjeteve dhe qëllimin e shërbimit;
- Mungesa e transparencës sa i përket ndjekjes dhe dokumentimit të shpenzimeve për karburant, të automjeteve që janë në dispozicion të institucionit.

- **Menaxhimi strategjik i risqeve:**

Në funksion të rritjes së integritetit në strukturat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe minimizimin e risqeve të identifikuar më sipër, në këtë Plan janë parashikuar masat si më poshtë:

- Hartimi dhe zbatimi i rregullave të qarta dhe specifike për përdorimin dhe shfrytëzimin e automjeteve;
- Pajisja me fletë-udhëtim të përditësuara për çdo lëvizje;
- Hartimi dhe zbatimi i procedurave për mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe inspektimin e gjendjes fizike dhe kushteve teknike, mirëmbajtjes;

Sa i përket arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit është një fushë me rëndësi në veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pasi përbën memorien institucionale të saj. Megjithatë strukturat mbikëqyrëse duhet të sigurohen gjithmonë se klasifikimi i informacionit nuk përdoret si justifikim dhe as bëhet për t'iu shmangur apo fshehur kontrollit dhe

se dokumentacioni administrohet në përputhje me parashikimet ligjore. Disa nga risqet e identifikuar evidentuar në këtë fushë janë:

- Akses i informacionit të klasifikuar i personave të pacertifikuar;
  - Lëshimi i informatave konfidenciale tek personat e paautorizuar;
  - Kushte të papërshtatshme të sigurisë në ambientet ku administrohet dokumentacioni.
- **Menaxhimi strategjik i risqeve:**

Në këtë kuadër, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse do të angazhohet për të njoftuar DPA për trajnimin e punonjësve të arkivës me qëllimin zbatimin me rigorozitet të procedurave për arkivimin e shkresave, rritjen e njohurive mbi administrimin e informacionit të klasifikuar; identifikimin dhe përmirësimin e mënyrës së qarkullimit të informacionit etj.

## • **VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT NË SEKTORIN E FINANCËS DHE BUXHETIT**

Spektori i Financës dhe Buxhetit ka në strukturë 3 (tre) Specialist dhe Përgjegjësi i Sektorit. Ky sektor mbulon një sektor me rëndësi të veçantë që përfshin risqe potenciale lidhur me korrupsionin.

### **Përgjegjësitë dhe objektivat e sektorit janë:**

- Menaxhimi efikas dhe transparent i burimeve që financojnë veprimtarinë e AKM-së, në zbatim të ligjit të buxhetit dhe ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Hartimi i dokumenteve të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA);
- Mbështetja dhe ngritja e sistemeve të kontrollit për përdorimin e financimit buxhetor vjetor të Agjencive Rajonale të Mjedisit;
- Asiston në përgatitjen e projekt buxhetit të AKM-së;
- Krijon dhe mban dokumentacionin ekonomik e financiar të AKM-së;
- Asiston në përgatitjen, mbajtjen dhe kuadrin e balancës së buxhetit të përgjithshëm të AKM.

### **Vlerësimi i Risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit ligjor, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

### **Reputacional**

Për të mundur arritjen e objektivave të AKM-së, Sektori i Financës dhe Buxhetit, synon të japë siguri objektive për vijimësinë e një aktiviteti normal të institucionit, duke përmbushur nevojat për infrastrukturën e nevojshme dhe shpenzime të tjera operative, duke përdorur me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të gjitha burimet financiare.

Delegimi financiar i vendimmarrjes brenda institucionit është i bazuar në rregullime ligjore dhe hierarkike mbi ekzekutimin e fondeve publike dhe kryerja e pagesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe udhëzimet përkatëse.

### **Financiar**

Niveli i riskut financiar të përcaktohet si më poshtë:

- Financim i pamjaftueshëm i nevojës për mallra dhe shërbime, çka sjell ulje të infrastrukturës dhe performancës së institucionit,
- Mungesa e një databaze mbi lejet e mjedisit të tipit A dhe B, që çon në mos-evidentimin e debitorëve të lejeve të mjedisit dhe kjo sjell të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.
- Burime financiare të kufizuara për shlyerjen e vendimeve gjyqësore, të cilat në raste të mos-shlyerjes së tyre rezultojnë në vendosjen e sekuestrove mbi fondet e institucionit.

### **Strategjitë për menaxhimin e riskut:**

Rritja e kontrollit të brendshëm, drejtimi i vazhdueshëm dhe korrekt i proceseve të menaxhimit financiar, por edhe të shpenzimit të shumave të alokuara, përbëjnë masa thelbësore në drejtim të parandalimit dhe uljes së riskut të korrupsionit.

Nga analiza e kryer rezulton se, menaxhimi i aseteve është gjithashtu një fushë e ekspozuar ndaj riskut të korrupsionit dhe cënimit të integritetit.

Në funksion të rritjes së integritetit në strukturat e AKM-së dhe minimizimin e risqeve të identifikuar ndaj menaxhimit të aseteve, në këtë plan janë parashikuar dhe janë marrë masat si më poshtë:

- Pajisja me fletë inventarë të përditësuara për çdo punonjës;
- Hartimi dhe zbatimi i procedurave për kontrollin periodik dhe inspektimin e gjendjes fizike dhe kushteve teknike e të mirëmbajtjes në inventarët nga strukturat përgjegjëse;

Në funksion të rritjes së integritetit në strukturat e AKM-së dhe minimizimin e risqeve të identifikuar ndaj buxhetit, janë parashikuar dhe janë marrë masat si më poshtë:

- Përgatitja e databazës mbi lejet e mjedisit të tipit A dhe B dhe tarifatat përkatëse;
- Kërkesa për shtesë fondi sipas nevojave të paparashikuara që mund të ketë institucioni gjatë vitit.

### **• VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT NË SEKTORIN JURIDIK DHE I MARRËDHËNIEVE LIGJORE**

**Sektori Juridik dhe i Marrëdhënieve Ligjore** ka në strukturë 3 (tre) specialist dhe Përgjegjësin e sektorit, ku 1 (një) pozicion specialist është vakant. Specialisti përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili varet nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt përpara Drejtorit të Përgjithshëm.

### **Objektivat dhe detyrat funksionale të sektorit janë:**

- Merr pjesë në komisione të ndryshme në zbatim të funksioneve që Agjencia ka, me qëllim shqyrtimin e ligjshmërisë;
- Hartimi dhe kontrolli i marrëveshjeve dhe kontratave që nënshkruan institucioni;
- Interpretimi ligjor dhe opinioni juridik mbi çështje të caktuara;
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për marrëdhëniet e AKM-së, ARM-ve si dhe me agjenci si motra brenda dhe jashtë vendit;
- Merr pjesë dhe kryeson komisionet e prokurimeve me urdhër të Titullarit deri në hartimin e kontratave për të zbatuar legjislacionin në fuqi;

- Përfaqësimi i institucionit në proceset gjyqësore me autorizim të posaçëm të Drejtorit të Përgjithshëm në të gjitha shkallët e gjyqimit për çështje të ndryshme ku Agjencia Kombëtare e Mjedisit është palë apo inicicion vetë një proces gjyqësor;
- Përgatit materialet shkresore të nevojshme/deklaratën e mbrojtjes në proceset gjyqësore, kërkesë paditë, prapësimet, ankimet, rekurset dhe të gjitha aktet e tjera procedurale për të garantuar përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të institucionit;
- Bashkëpunon me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë Sektorit apo Drejtorisë, si dhe me institucionet e varësisë, për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme, të cilat kërkojnë interpretim ligjor.

Përsa i përket llogaridhënies në strukturat eprorë, ky sektor konsultohet me eprorët dhe strukturat përkatëse të specializuara në fushën brenda objektit të procesit gjyqësor për hartimin e akteve si kërkesë paditë, deklarata mbrojtjeje, prapësime, ankime, rekurse dhe raportin mbi mbarëvajtjen në fund të çdo procesi.

Si i tillë, niveli i riskut të korrupsionit në Sektorin Juridik dhe të Marrëdhënieve konsiderohet i ulët pasi ky sektor nuk ka procese apo struktura të ndjeshme dhe të ekspozuara direkte ndaj korrupsionit.

### **Vlerësimi i risqeve**

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit ligjor, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

#### **Reputacional**

Sektorin Juridik dhe i Marrëdhënieve Ligjore bën përfaqësimin ligjor të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në bashkëpunim sipas rastit, edhe me specialistë të fushës për çështje të caktuara sipas objektit të padisë. Në çështje që kanë një rëndësi të veçantë në opinionin publik, në gjykim mund të jenë prezente edhe mediat. Në çdo rast, nëpunësi i këtij sektori përpiqet të bëjë një përfaqësim sa më të denjë, të argumentojë me prova dhe fakte qëndrimet e tij në mënyrë që të mos lërë vend për keqinterpretim.

Nëpunësi i këtij sektori ka përballë në seancë gjyqësore një person që në vetvete është publik dhe për të mbrojtur interesat e institucionit, përdor të gjitha mjetet ligjore të nevojshme.

#### **Financiar**

Nga proceset gjyqësore mund të vijnë kosto të larta financiare mbi pagesat e palëve paditëse sipas objektit të padisë, prandaj nëpunësi i këtij sektori kujdeset gjithmonë që të jetë sa më efektiv në mbrojtjen e interesave të institucionit.



- **TRANSPARENCA E PUNËS DHE E VEPRIMTARISË SË AKM-SË, ME AKTORË TË JASHTËM TË INTERESUAR DHE PUBLIKUN**

## **1. FAQJA ZYRTARE E INTERNETIT**

Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron një faqe zyrtare web <https://akm.gov.al/> dhe në mënyrë periodike në faqe publikohen të dhënat për veprimtarinë e institucionit dhe informacione të tjera të cilat i shërbejnë publikut, të tilla si: faturat për arkëtimin e pagesave për kërkesë për leje mjedisi, ndryshim të kushteve të lejes, pagesa periodike vjetore, për pagesën e masave administrative të vendosura, njoftime të ndryshme, përditësohet Programi i Transparencës, Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve etj.

## **2. KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Në zbatim të nenit 10 të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit me anë të urdhërit Nr.7, datë 18.01.2022 ka vendosur “Caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit në AKM”.

Koordinatori kryen këto detyra:

- a) i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;
- b) krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar;
- c) bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj;
- ç) regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;
- d) dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;
- e) kryen njoftimet paraprake, si dhe komunikon me kërkuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

- **VLERËSIMI I PYETËSORËVE TË VETËVLERËSIMIT TË PLOTËSUAR NGA PUNONJËSIT**

Si një ndër burimet e vlerësimit të riskut të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në përputhje me MVRI, u përdor “Pyetëtori vetëvlerësimi për punonjësit e institucionit sipas shtojcës 3 të “Metodologjia e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”; Referuar plotësimit të këtij pyetëtori vihet re se disa punonjës nuk janë të informuar në lidhje me rregulloren për “Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”.

**Menaxhimi strategjik i riskut:**

Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse do të angazhohet për informimin e punonjësve mbi rregulloren për “Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”.

## **MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

Objektivat strategjikë të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për secilin aktivitet të parashikuar.

Monitorimi është periodik (çdo 6 muaj) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit. Koordinator i caktuar për monitorimin e zbatimit të planit të integritetit është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficiente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimeve për planifikim më të mirë në të ardhmen.

## 1. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

Objektivi: Rritja e efektivitetit në sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse							
Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Informimi mbi “Rregullore për etikën dhe konfliktin e interesave të punonjësve të AKM”	Punonjës të informuar	6M2 2023 - 2024	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	I mesëm	Mundësi për mungesë të sjelljes etike dhe profesionale të punonjësve	Informimi i punonjësve	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
Plotësimi i vakancave në organikën e institucionit	Vakanca të plotësuara	6M2 2023 - në vijimësi	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	I lartë	Mbingarkesë në përmbushjen e detyrave funksionale nga punonjësit dhe mundësi për performancë të ulët të institucionit	Emërimi i punonjësve për vendet vakante	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
Hartimi dhe zbatimi i programeve specifike për përdorimin dhe shfrytëzimin e automjeteve	Eficensë në përdorimin dhe kontrollin e automjeteve	Në vijimësi	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	I lartë	Mundësi për përdorimin e automjeteve pa miratim	Miratimi i urdhërave dhe programeve të kontrollit nga titullari i institucionit	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
Pajisja me fletë-udhëtimi të përditësuara për çdo lëvizje	Eficensë në përdorimin dhe kontrollin e automjeteve	Në vijimësi	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	I lartë	Mundësi për përdorimin e automjeteve pa miratim	Fletë-udhëtimi të firmosura nga grupi i punës	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Hartimi dhe zbatimi i procedurave për mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe inspektimin e gjendjes fizike dhe kushteve teknike, mirëmbajtjes së automjeteve	Eficensë në përdorimin dhe kontrollin e automjeteve	Në vijimësi	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	I lartë	Mospërditësimi në kohë i gjendjes së automjeteve sjell cënimin e vijueshmërisë së punës	Grupet e punës të cilët marin automjetet në përdorim çdo 6 muaj ose 1 herë në vit sipas rastit, paraqesin relacion për gjendjen e automjetit	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
Zbatimi me rigorozitet të procedurave për arkivimin e shkresave, rritjen e njohurive mbi administrimin e informacionit të klasifikuar; identifikimin dhe përmirësimin e mënyrës së qarkullimit të informacionit	Zbatimi me rigorozitet i ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”	Në vijimësi	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	I lartë	Moszbatimi i saktë i ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”	Shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për trajnim	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

## 2. Transparenca me publikun

**Objekivi: Forcimi i një sistemi funksional të integritetit në Agjenci përmes transparencës me publikun**

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Vijueshmëria e funksionimit të faqes zyrtare në internet	Faqe zyrtare funksionale	6M2 2023 - në vijimësi	IT e AKM	I lartë	Pamundësia e publikimeve zyrtare në faqe dhe mosgarantimi i informimit efektiv të publikut	Bashkëpunimi ndërmjet drejtorive të AKM dhe IT së AKM, për informacionet që do të publikohen	IT dhe drejtoritë e AKM-së

## 3. Menaxhimi i buxhetit dhe financës

**Objekivi: Minimizimi i risqeve të identifikuara ndaj menaxhimit të aseteve dhe buxhetit**

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Pajisja me fletë inventarë të përditësuara për çdo punonjës;	Menaxhimi i mirë i aseteve	6M 2023 - në vijimësi	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I ulët	Mospërditësimi në kohë i aseteve në ngarkim të punonjësve, për punonjësit të cilët emërohen apo lirohen nga detyra	Bashkërendimi i sektorit të financës dhe punonjësve	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Hartimi dhe zbatimi i procedurave për kontrollin periodik dhe inspektimin e gjendjes fizike dhe kushteve teknike e të mirëmbajtjes në inventarët nga strukturat përgjegjëse	Menaxhimi i mirë i aseteve	6M 2023 - në vijimësi	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I ulët	Mospërditësimi në kohë i gjendjes së aseteve sjell cënimin e vijueshmërisë së punës	Bashkërendimi i sektorit të financës dhe punonjësve	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Përgatitja e databazës mbi lejet e mjedisit të tipit A dhe B dhe tarifatat përkatëse	Evidentimi i saktë i fondeve që derdhen në Buxhetin e Shtetit nga veprimtaria e institucionit	6M 2023 - në vijimësi	Sektori i Financës dhe Buxhetit	I lartë	Mungesa e një databaze mbi lejet e mjedisit të tipit A dhe B, çon në mos-evidentimin e debitorëve të lejeve të mjedisit dhe kjo sjell të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.	Bashkërendimi i sektorit të financës dhe Drejtorisë së Lejeve dhe VNM	Sektori i Financës dhe Buxhetit
Kërkesa për shtesë fondi sipas nevojave të paparashikuara.	Vijueshmeria normale e punës pa cënuar performancën për arritjen e objektivave të institucionit	6M 2023 - në vijimësi	Sektori i Financës dhe Buxhetit	I lartë	Burime financiare të kufizuara për shlyerjen e vendimeve gjyqësore, të cilat në raste të mos-shlyerjes së tyre rezultojnë në vendosjen e sekuestrove mbi fondet e institucionit, si dhe të nevojës për mallra dhe shërbime	Sektori i Financës dhe Buxhetit sipas nevojave të institucionit	Sektori i Financës dhe Buxhetit

#### 4. Menaxhimi i sektorit të kimikateve

Objektivi: Përgatitja e Regjistrit Kombëtar të Kimikateve							
Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Krijimi dhe mbarëvajtja e RKK	Databazë e saktë e renditjes së të gjitha kimikateve	6M2 2023 - në vijimësi	Sektori i Kimikateve	I mesëm	Mosdisponimi i një dataze të saktë të të gjitha kimikateve	Bashkëpunimi me MTM dhe me ekspertë të projektit nga Agjencia Suedeze e Kimikateve	Sektori i Kimikateve

#### 5. Menaxhimi i sektorit të Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)

Objektivi: Ekzekutimi i Masave Administrative							
Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Krijimi i një kanali komunikimi praktik dhe të aksesueshëm për përditësimin dhe raportimin e databazës së ARM-ve në AKM.	Databazë e saktë e kundërvajtjeve administrative	6M2 2023 - në vijimësi	Sektori i Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)	I lartë	Mosdisponimi i një dataze të saktë të të gjitha kundërvajtjeve administrative	Bashkëpunimi me ARM	Sektori i Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)
Kërkesë për informacion Gjykatës kur ka vonesa në lëshimin e urdhërave të ekzekutimit	Ekzekutimi në kohë i masave administrative	6M2 2023 - në vijimësi	Sektori i Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)	I lartë	Mosekzekutimi në kohë i masave administrative	Kërkesa drejtuar Gjykatës	Sektori i Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)